



Terre des hommes

Ndihmë për fëmijët në mbarë botën [tdh.ch](http://tdh.ch)

# Sistemi i Mbrojtjes së Fëmijëve "Në Ndërtim e Sipër"

---



**Katër historitë e fëmijëve të cilët kanë nevojë për mbrojtje në Shqipëri**

# **Sistemi i Mbrojtjes së Fëmijëve**

## **"Në Ndërtim e Sipër"**

**Katër historitë e fëmijëve të cilët kanë nevojë për mbrojtje në Shqipëri<sup>1</sup>**

---

<sup>1</sup> Ky material përmbledhës është si rezultati i kërkimeve dhe është përgatitur për Misionin Terre des hommes (Tdh) në Shqipëri nga Fotis Filippou (konsulent i jashtëm) në bashkëpunim me stafin e Tdh-së. Falenderoj stafin e Tdh-së që asistoi gjatë kërkimit, përgatitjes dhe përfundimit të këtij materiali si dhe të gjitha OJQ-të, përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe vendore që u intervistuan për këtë kërkim.

*Fëmijët në Shqipëri, të cilët vuajnë nga neglizhimi, dhuna, abuzimi, puna e detyruar, fëmijët në situatë rruge apo ata në konflikt me ligjin, gjenden në situata të rrezikshme. Në Shqipëri, ende nuk ka një sistem efektiv për t'i mbrojtur nga fenomene të tilla, duke ju mohuar kështu këtyre fëmijëve të drejtat e njeriut dhe duke i dënuar të vuajnë një jetë të marginalizuar dhe të vazhdojnë ciklin e abuzimit.*

*Ky informacion fokusohet tek historitë e katër fëmijëve që kanë vuajtur abuzimin, shfrytëzimin dhe dhunën dhe të cilët kanë pasur kontakt me shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të kujdesit në Shqipëri. Nëpërmjet historive të tyre, ky material synon të nxjerr në pah elementet pozitive dhe progresin e sistemit aktual si dhe të tërheq vëmendjen për mangësitë që ngelen. Falenderojmë të gjithë fëmijët që ndanë historitë e tyre dhe përvojën personale për këtë material.<sup>2</sup>*

---

<sup>2</sup> Shënim për metodologjinë: Kërkimi në terren dhe intervistat me fëmijët, familjet e tyre, përfaqësuesit e institucioneve qeveritare dhe OJQ-të janë kryer në periudhën Prill dhe Maj 2015. Për intervistat me fëmijët u kërkua pjesëmarrja e tyre dhe u përdoren mjete të kujdesshme për fëmijët në mënyrë që të rindërtonin përvojën e tyre me shërbimet e kujdesit dhe të mbrojtjes. Kërkimi në terren u plotësua edhe nga analiza që ju bë studimeve të institucioneve qeveritare, IGO dhe OJQ-ve që punojnë në fushën e mbrojtjes së drejtave të fëmijëve.

Konventa për të Drejtat e Fëmijëve (KDF), pjesë e së cilës është edhe Shqipëria që prej 1992, thekson nevojën e qeverisë sipas të drejtës ndërkombëtare, të mbrojtjes së fëmijëve me të gjitha të drejtat e tyre.<sup>3</sup> KDF-ja kërkon që të gjithë aktorët që punojnë për shtetin të marrin të gjitha masat e nevojshme 'ligjore, administrative, sociale dhe edukative për të mbrojtur fëmijët nga të gjitha format e dhunës mendore apo fizike, dëmtimit apo abuzimit, neglizhimit apo sjelljes neglizhuese, keqtrajtimit apo shfrytëzimit, përfshirë abuzimin seksual, ndërkohë që fëmija është nën kujdesin e prindit (prindërve), kujdestarit ligjor apo të çdo personi tjetër që duhet të kujdeset për fëmijën."<sup>4</sup> E drejta për t'u mbrojtur nga abuzimi dhe shfrytëzimi nuk është e izoluar pasi gëzimi i kësaj të drejte varet edhe nga një gamë të drejtash të tjera si e drejta për kujdes shëndetësor, edukim dhe standarde të pranueshme jetese, e drejta për drejtësi dhe të drejta të tjera. KDF gjithashtu parashikon se "në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike apo private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative ose organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese."<sup>5</sup>

Shqipëria, pas përfundimit të regjimit komunist në 1991, dhe për shkak të izolimit të mëparshëm, filloi zhvillimin e infrastrukturës për shërbimet sociale nga nivele të ulta<sup>6</sup> dhe ju duhej të plotësonin nevojat gjithnjë e në rritje të shumë familjeve.<sup>7</sup> Vetëm rishtazi ka dalë koncepti i sistemit të mbrojtjes së fëmijëve dhe elementet që po lindin bashkë me të dhe siç vuri në dukje edhe Kreu i Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve (paskëtaj Agjencia Shtetërore): "Ende nuk ka një përkufizim të qartë se çfarë nënkuptojmë me mbrojtje të fëmijëve dhe as vizion apo strategji afatgjate. Kemi gjëra pozitive, por deri tani janë të copëzuara."

Vitet e fundit, Shqipëria ka ndërmarrë një sërë nismash që adresojnë nevojën e fëmijëve për mbrojtje nga trafikimi, për fëmijët në situatë rruge dhe parandalimin e institucionalizimit. Megjithatë, siç edhe nënvizoi Drejtori i OJQ-së ARSIS, "shumica e projekteve janë kryer nga projektet" dhe mungon një plan për një periudhë më afatgjatë.

Shërbimet e mbrojtjes deri pak kohë më parë, kufizoheshin vetëm tek ato pak institucione rezidenciale. Janë hedhur hapa pozitiv për krijimin e strukturave dhe qasjeve të reja për të plotësuar nevojat e fëmijëve për mbrojtje. Më së shumti, këtu përfshihen krijimi i Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) si struktura e vetme e specializuar si mekanizëm referimi në nivel lokal si dhe angazhimi në rritje i qasjeve multi-disiplinare ndaj menaxhimit të rastit dhe ndërhyrjes mbështetur tek "Protokolli Punës për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve".

Megjithatë, është dakordësuar midis OJQ-ve dhe përfaqësuesve të autoriteteve shtetërore se shërbimet ekzistuese nuk përbëjnë domosdoshmërisht një 'sistem' për mbrojtjen e fëmijëve, por janë më shumë një 'mozaik' shërbimesh. Kreu i Agjencisë Shtetërore vuri në dukje se: "ende nuk ekziston ideja e 'një sistemi për mbrojtjen e fëmijëve'. Nuk kemi arritur ta fusim në rutinën e punës së institucioneve të ndryshme." Krahas kësaj, edhe pse miratimi i ligjit "Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve" në 2010 ka qenë hap pozitiv, vazhdon të mungojë kuadri i plotë ligjor i cili adreson specifikisht nevojat e fëmijëve. Ky kuadër legjislativ do të ishte çelësi për të caktuar të gjithë elementet e sistemit të mbrojtjes të fëmijëve dhe për të përkufizuar rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë aktorëve, pjesët përbërëse dhe sistemet e ndërlidhura si sistemi arsimor, ai shëndetësor dhe i drejtësisë.

3 Konventa mbi Të Drejtat e Fëmijëve (KDF), e adoptuar më 20 nëntor 1989, G.A. Res. 44/25, annex, 44 U.N. GAOR Supp. (No. 49) at 167, U.N. Doc. A/44/49 (1989), gjendet tek: <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CRC.aspx>

4 CRC, Neni. 19

5 CRC, Neni. 3

6 Rachel A Harris dhe Ian Milligan, për Misionin e Terre des hommes në Shqipëri, *Vizion i përbashkët për mbrojtjen sistematike të fëmijëve: Praktikat e mira nga Shqipëria*, maj 2014 fq. 12 (raporti brendshëm)

7 Gary Westwater dhe Vladan Jovanović, për Austrian Development Cooperation dhe UNICEF Shqipëri, *Vlerësim i ndërhyrjes së Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve në kuadër në reformës për sistemin e mirëqenies sociale dhe decentralizimit të procesit të shërbimeve sociale në Shqipëri*, Shtator 2009, p. 12




# Mbrojtja e Fëmijëve në Nivel Lokal: Realiteti në Terren

Në mënyrë që ketë një sistem efektiv, janë jetike kontributet e shumë agjencive; është përgjegjësia e shumë aktorëve për t'u kujdesur për fëmijët, të garantohet mirëqenia e tyre dhe të mbrohen të drejtat e tyre. Kjo përfshin, krahas prindërve dhe pjesëtarëve të komunitetit më të gjerë edhe një numër institucionesh dhe profesionistësh të cilët në mënyrë direkte apo indirekte janë të përfshirë në mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve (shërbimet sociale, kujdesi shëndetësor, arsimi, policia, drejtësia, media, etj.). Ligji parashikon krijimin e një NJMF-je tek çdo strukturë e njësive administrative në Shqipëri (bashki apo komuna) për të koordinuar mbrojtjen, referimin dhe analizën e rasteve në territor. Kjo do të zbatohet në bashkëpunim me këta aktorë nëpërmjet një qasjeje multi-disiplinore për menaxhimin e rastit dhe ndërhyrjen (shikoni grafikun (Flow Chart) për procesin e menaxhimit të rastit<sup>8</sup>). Të gjithë aktorët duhet të njohin dhe të jenë të ndjeshëm për çështjet e mbrojtjes së fëmijëve dhe të dinë si t'i adresojnë në qasje me shumë agjenci.

Për të koordinuar në mënyrë efektive shërbimet e mbrojtjes së fëmijëve me të gjithë aktorët, NJMF duhet të ketë të paktën një punonjës (Punonjës për Mbrojtjen e Fëmijëve (PMF) të kualifikuar si punonjës social. Tdh dhe organizatat e tjera që punojnë në fushën e mbrojtjes së fëmijëve janë të shqetësuar se NJMF-ve ju mungojnë në praktikë kualifikimet, kapacitetet, aftësitë dhe buxheti për të përmbushur rolin e tyre me efektivitet. Aktualisht, NJMF-të janë të vendosura vetëm në 196 njësi, vetëm gjysma, e njësive administrative në Shqipëri dhe në veçanti mungojnë në zonat rurale. Krahas kësaj, vetëm pak NJMF kanë punonjës të dedikuar; në shumicën e rasteve është emëruar një administrator i përkrahjes sociale. Megjithëse një numër i PMF-ve janë të kualifikuar dhe të dedikuar, të tjerët nuk janë punonjës social të kualifikuar dhe janë të emëruar nga politika.

Mungesa e kapaciteteve dhe buxhetit janë ndër sfidat më të mëdha me të cilat përballlet PMF-ja kur bëhet fjalë për identifikimin efektiv dhe menaxhimin e rastit. Kjo kombinohet edhe me mungesën e shërbimeve, përfshirë shërbimet e specializuara, për fëmijët në nivel vendor dhe është shumë serioze në kontekstin e situatave emergjente. Aktualisht, për shembull ka vetëm dy qendra emergjence në Shqipëri dhe të dyja në Tiranë. Shërbimet e referimit nuk funksionojnë 24 orë, pas orarit të punës për PMF-të. Një shqetësim tjetër është se shpesh ndërhyrjet kufizohen vetëm me masa imediate dhe urgjente, por nuk hartohet plan afatgjatë për të garantuar se fëmija nuk do të përfshihet sërish në situatë të rrezikshme.

<sup>8</sup> Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Misioni Terre des hommes në Shqipëri, UNICEF në Shqipëri, "Protokolli Punës për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve", 2010, fq. 42, <http://childhub.org/child-protection-online-library/working-protocol-child-protection-workers>



Menaxhimi efektiv i rastit nëpërmjet grupit multi-disiplinar të aktorëve lokal është një nga sfidat e tjera të mëdha. Megjithëse, është përmirësuar bashkëpunimi midis agjencive të ndryshme në nivel vendor, sidomos aty ku ka NJMF të fortë e cila luan një rol të mirë koordinues, vazhdon të mbetet ulët ndërgjegjësimi për rolin dhe shërbimet tek aktorët e tjerë përkatës, si profesionistët e arsimit dhe shëndetësisë. Më e rëndësishme është se mungon kuptimi dhe angazhimi për mbrojtjen e fëmijëve si përgjegjësi e të gjithë aktorëve të nivelet lokal, si psikologët e shkollave dhe mësuesit, punonjësit e shëndetësisë dhe policia. Kjo kufizon mundësitë për parandalim dhe nënkupton gjithashtu se rastet e fëmijëve në rrezik mund të mos referohen asnjëherë tek grupi multid-disiplinar për ndërhyrje ose aktorët përkatës nuk marrin pjesë tek takimet për menaxhimin e rastit. Janë të kufizuara mundësitë që vetë fëmijët apo qytetarët të kërkojnë ndihmë drejtëpërdrejtë ose t'i referojnë rastet tek NJMF-ja apo institucionet e tjera.

Decentralizimi i përgjegjësisë për mbrojtjen e fëmijëve në nivel lokal nuk u kombinua dhe me zhvillimin e një kuadri monitorues dhe mekanizmi për përgjegjshmërinë. Ky është një boshllëk i madh dhe një problem, tregues se ekziston një 'mozaik' në vend që të ketë një qasje 'sistematike' për mbrojtjen e fëmijëve.

Aktualisht, qeveria shqiptare po kryen reformë në shërbimin social shtetëror dhe reformë territoriale dhe administrative. Tdh dhe organizatat e tjera janë të shqetësuara për mungesën e qartësisë së këtyre shërbimeve, strukturave dhe burimeve që do të jenë të disponueshme për mbrojtjen e fëmijëve sipas njësive të reja administrative pas zgjedhjeve vendore të Qershorit 2015.



## Fëmijët në situatë rruge

Fëmijët në situatë rruge, të përfshirë në aktivitete si lypja, shitja e sendeve, riciklimi apo qoftë edhe ata që jetojnë në rrugë, përfaqësojnë një nga grupet me vulnerabël në Shqipëri; Sipas një studimi në 2014 mbi fëmijët në situatë rruge në Shqipëri, nga UNICEF dhe Save the Children ata vijnë nga një mjedis i pafavorshëm shoqëror dhe ekonomik dhe kanë pak akses ndaj shërbimeve sociale dhe janë tejet të marginalizuar. Shumë prej tyre janë në rrezik trafikimi. Si rezultat, është në rrezik shëndeti dhe integriteti i tyre fizik, ata nuk mund ta gëzojnë të drejtën e tyre për edukim dhe ndikon tek zhvillimi i tyre personal. Sipas një studimi gati 75 përqind e fëmijëve që janë pjesë e sondazhit, i përkasin grupeve etnike<sup>9</sup> Rome dhe Egjiptiane – dhe përfaqësimi i tyre tek fëmijët në situatë rruge është tepër i lartë po të kemi parasysh se Romët dhe Egjiptianët përbëjnë më pak se 3.5 përqind të popullsisë totale në Shqipëri.<sup>10</sup>

Qeveria shqiptare filloi një projekt Plan për Masat ndaj Fëmijëve në Situatë Rruge në 2014 për të identifikuar fëmijët që janë në situatë rruge vetëm ose me familjet e tyre dhe për të bërë ndërhyrjet për të rikthyer ata në shoqëri. U ngritën 11 ekipe terreni në Tiranë, një për secilën minibashki, ekipe të përbëra nga dy ose tre persona; PMF-ja, e minibashkisë, punonjës social nga OJQ-ja dhe kur ishte e nevojshme një punonjës social nga Sekretariati i Task Forcës i ngritur nga Agjencia Shtetërore për të koordinuar dhe për të mbështetur ekipet e terrenit, dhe kur ishte e nevojshme kërkohet edhe mbështetja e policisë. Pasi u bë identifikimi fillestar nga ekipet e terrenit, rastet supozohet të trajtohen nga grupi multi-disiplinar. Organizata si Tdh dhe ARSIS e kanë mbështetur këtë nismë pilote si me ekspertizë dhe me burime financiare. Megjithë shqetësimin e OJQ-ve për aftësive dhe kapaciteteve të dobta të ekipeve të terrenit, Drejtori i ARSIS-it e mirëpriti “kjo është hera e parë që shteti bën një shtrirje të tillë në fushën e punës sociale.”

<sup>9</sup> UNICEF dhe Save the Children, *Studim Kombëtar për fëmijët në situatë rruge në Shqipëri*, fq. 35, kërkoni tek: [http://www.unicef.org/albania/NationalStudy-children\\_in\\_street\\_situation-June2014.pdf](http://www.unicef.org/albania/NationalStudy-children_in_street_situation-June2014.pdf)

<sup>10</sup> Numërohen afërsisht 120,000 Romë dhe Egjiptian që jetojnë në Shqipëri, tek një popullsi totale prej 3.4 milion personash. Shiko Qendra Evropiane për të Drejtat Rome, “Fakte Bazë për Romët - Shqipëri”, gusht 2010, <http://www.errc.org/article/basic-facts-on-roma--albania/3622>





> Zamira, Lindita dhe Gezimi në shtëpinë e tyre ku jetojnë në kushte të papërshtatshme, vizatojnë shtëpi të bukura plot ngjyra ku do të dëshironin të jetonin. Tiranë, Shqipëri, prill 2015



# Zamira, Lindita, Nexhat, Arjana dhe Gëzimi<sup>11</sup>

Fatime është 25 vjece dhe nëna e pesë fëmijëve. Ajo ka lindur në Elbasan dhe është zhvendosur në Tiranë para 20 vitesh. Qysh prej moshës katër vjeçare Fatima ka lypur në rrugë. Partneri i saj i fiton paratë duke ricikluar mbeturina. Fëmijët e saj, Zamira 10 vjeç, Lindita shtatë, Nexhati gjashtë, Arjana katër dhe Gëzimi një vjeç e gjysëm kanë lypur me Fatimen në rrugë që nga dita e lindjes. Familja, e komunitetit egjiption kanë qenë në gjendje shumë të vështirë socio-ekonomike, por me përfshirjen e të gjithë anëtarëve në aktivitete informale për nxjerrjen e të ardhurave kanë arritur të nxjerrin jetesën. “Fëmijët më kanë ndihmuar shumë. Po nxirrnim shumë para. Blemë rroba, ushqime dhe mund të paguanim qiranë.”

Tetë vitet e fundit familja ka jetuar me qira 7,000 Lek në muaj në një apartament në zonën e Kombinatit në Tiranë. Jetojnë të gjithë në një dhomë që ndahet me perde, pa ujë në apartament dhe kushtet janë të tmerrshme. Për anën sanitare, apartamenti ka një tualet jashtë që e ndajnë me të tjerë dhe është i papërshtatshëm. Që prej 2005, ARSIS i ka ofruar përkrahje familjes me ushqime, veshje si dhe ndihmë mjekësore si dhe e kanë ndihmuar me qiranë dhe e kanë regjistruar familjen tek skema e ndihmës sociale. Marrin 5,000 Lek në muaj asistencë financiare.

Në nëntor 2013, ARSIS e referoi rastin tek NJMF-ja Nr. 9; së bashku i ofruan asistencë të menjëhershme materiale familjes. Në atë kohë NJMF-ja Nr.9 ishte një nga pak Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve në Tiranë dhe ishte shumë i kufizuar kapaciteti i saj për të monitoruar dhe për të menaxhuar rastet në mënyrë efektive. Me rritjen e numrit të NJMF-ve në janar 2014, dhe me vënien në zbatim në Prill 2014 të Planit të Veprimit për Fëmijët në Situatë Rruge, është përmirësuar disi identifikimi dhe ndjekja e rasteve. Në maj 2014, një ekip terreni identifikoi fëmijët që lypnin sërish me mamanë në zonën e Laprakës në Tiranë. Përfaqësuesi i task forcës ja referoi rastin NJMF-së nr. 9, aty ku kanë edhe regjistrin civil. Por, duke qenë së jetojnë në zonën e Kombinatit që është tjetër njësi administrative në Tiranë, rasti ju transferua NJMF-së Nr. 6.

Pasi u bë vizita në familje dhe vlerësimi fillestar në Shtator 2014, PMF thirri grupin multi-disiplinar të zhvillonin një plan veprimi për ndërhyrje. Sipas PMF-së, Fatimja ishte shumë bashkëpunuese në fillim dhe i hoqi menjëherë fëmijët nga rruga. Në bashkëpunim me ARSIS, PMF-ja i ndihmoi të regjistronin fëmijët tek Njësia Nr. 6 dhe asistoi mamanë të regjistronte vajzat në shkollën e zonës fillore për herë të parë. Nexhati, gjithashtu në moshën e shkollës fillore filloi të merrte pjesë në qendrën ditore të Arsistit dhe në shtator 2015 do të fillojë shkollën.

Kur ndaluan lypjen, Fatimja tha se familjes ju ulën të ardhurat shumë. ARSIS-i dhe bashkia e përkrahën familjen me paketa ushqimore. Objektiva e dytë e planit të veprimit ishte të punësohej Fatimja në punë të rregullt, i krijuar nga grupi multi-disiplinar dhe e referuan tek zyra punësimit për ta regjistruar për punë. Por, me dy fëmijët e vegjël në shtëpi, ishte e vështirë për Fatimen që të gjente punë dhe Zamira, vajza më e madhe shpesh nuk shkonte në shkollë për të ndenjtur në shtëpi që të kujdesej për fëmijët më të vegjël. “Në këto kushte vendosëm të thërrisnim një grup tjetër multi-disiplinar për të regjistruar fëmijët më të vegjël në kopsht,” tha PMF-ja. Ajo na shpjegoi se normalisht është tepër e vështirë të gjeësh vend në kopsht për këta fëmijë, pasi ka pak vende edhe drejtorët hezitojnë t’i pranojnë.

11 Të gjithë emrat e individëve në këtë material janë ndryshuar për të mbrojtur identitetin dhe fshehtësinë e tyre.

Fëmijët e Fatimes largohen nga shtëpia ku jetonin në kushte të papërshtatshme. Tiranë, Shqipëri, prill 2015

Megjithatë, në këtë rast me mbështetjen e ARSIS, që mbuloi edhe pagesën, arritën të siguronin një vend për Arjanën në kopsht dhe Gëzimin në çerdhe.

Kushtet e jetesës së familjes ishin tjetër problem që adresoi grupi-multidisiplinar. Për shkak të të ardhurave të pakta të familjes dhe pasigurisë financiare, Fatimja luftonte për të paguar qiranë. Me mbështetje fillestare për pagesën e qirasë nga OJQ-të, grupi multi-disiplinar e referoi më pas Fatimen tek bashkia ku kërkoi asistencën për të pastrehët që të mbulonte 50% të qirasë. Asistuar nga ARSIS, Fatimja aplikoi për banesë sociale në Prill 2014, por sipas punonjësit social të organizatës, janë shumë të pakta mundësitë që ta fitojë për shkak të kushteve strikte.

### Integrimi në shkollë

Në shtator 2014, si Zamira dhe Lindita filluan klasën e parë. Mësuesit thanë se janë të zgjuara, por u ankuan për mungesën e interesimit nga ana e prindërve për edukimin e vajzave dhe se ato duke mos shkuar rregullisht në shkollë kishin vështirësi të kapnin mësimet. Fatimja pohoi se vajzat shkojnë në shkollë vetëm dy-tre herë në javë. Drejtori shkollës dhe mësuesit këmbëngulën se vajzat nuk diskriminoheshin për shkak të origjinës së tyre apo të shkuarës së tyre në rrugë. Megjithatë, nga komentet e tyre të përgjithshme për fëmijët romë dhe egjiptianë në shkollë, kuptohej se nuk kishin shumë njohuri apo ndjeshmëri për situatën e tyre socio-ekonomike dhe historitë personale të vajzave, çka mund të refleктоhej tek sjellja e tyre dhe nuk ndihmon integrimin: "Higjena e tyre është sfidë. Kanë morra dhe vijnë erë se nuk lahen. Prindërit e tjerë ankohen dhe nuk duan që të ulen në të njëjtën tavolinë me fëmijët e tyre."



Kur i takoi Tdh në prill 2015, vajzat thanë se ishin të lumtura në shkollë dhe me mësuesit e tyre, sidomos Zamira, por thanë se detyrat ishin të vështira dhe nuk bënin asnjëherë aktivitete si vizatime. Zamira dukej më e integruar ndërsa Lindita dukej sikur përqipet më shumë të socializohet në shkollë. Megjithatë, të dyja vajzat thanë se ju pëlqente më shumë shkolla sesa lypja. “është e vështirë të rrih në rrugë, sidomos kur bën shumë vapë,” tha Zamira dhe Lindita e pohoi, “ishte shumë keq.” Fatimja i tha Tdh se vajzat nuk janë ankuar asnjëherë për shkollën apo mësuesit– “Është gjithmonë shkolla dhe mësuesit që ankohen për ato.”

Fëmijët romë dhe egjiptian braktisën shkollën në moshë të vogël për shkak të diskriminimit, varfërisë, martesave në moshë të hershme sidomos për vajzat, apo traditave që mund të kenë prindërit. Sipas UNDP “kjo ndodh për shkak të ambientit patriarkal ku rriten vajzat, ku vajzat nuk duhet të shoqërohen me djemtë kur hyjnë në moshën e adoleshencës.”<sup>12</sup> Autoritetet mund t’i pranojnë këto praktika si të mirëqena dhe shpesh nuk ofrojnë mbrojtje ligjore kur vajzave rome ju shkelen të drejtat e tyre.<sup>13</sup> Braktisja e shkollës në moshë të hershme dhe martesat në moshë të hershme nuk i lejojnë vajzat rome dhe egjiptiane të arrijnë potencialin e tyre të plotë dhe të marrin pjesë plotësisht në jetën sociale, ekonomike dhe të komunitetit të tyre.

Fatimja i tha Tdh-së se ishte e sigurt që nuk do t’i nxirrte fëmijët në rrugë: “As nuk më shkon në mendje t’i nxjerr prapë në rrugë. Më mirë të vdes. Fëmijët nuk duhet të vuajnë në vapë e në të ftohtë. Nuk i linda që të vuajnë.” PMF-ja shpjegoi se kishin punuar shumë me nënën që ta ndërjegjësonin dhe ta mbështesnin: “E vërteta është që ka gati një vit që nuk i ka nxjerrë më fëmijët në rrugë dhe është shumë mirë. Megjithatë, ekziston akoma rreziku.” Dhe në fakt rasti i fëmijëve të Fatimes mund të konsiderohet si i suksesshëm pasi fëmijët janë hequr nga rroga dhe janë regjistruar në shkollë. Megjithatë, mbetet sfida fuqizimi familjes për të futur Fatimen në punë të qëndrueshme dhe të adresohen problemet që ndeshin fëmijët në shkollë për shkak të prejardhjes së tyre dhe gjendjes socio-ekonomike. PMF-ja theksoi se për vështirësi të tilla familja ka nevojë të ndiqet për një kohë të gjatë dhe të qëndrueshme për të paktën dy ose tre vjet, derisa të fuqizohen për të ecur me këmbët e tyre. Është jetike që të bëhet punë me shkollën dhe aktorët e tjerë për të garantuar integrimin e suksesshëm të fëmijëve në jetën larg rrugës dhe situatave të tjera të shfrytëzimit dhe abuzimit.

<sup>12</sup> UNDP, *Në rrezik: Vulnerabiliteti social i Romëve në Shqipëri*, fq. 26, [http://europeandcis.undp.org/uploads/public/File/rbec\\_web/vgr/Albanian\\_Roma\\_Report\\_english\\_reduced.pdf](http://europeandcis.undp.org/uploads/public/File/rbec_web/vgr/Albanian_Roma_Report_english_reduced.pdf)

<sup>13</sup> Qendra Evropiane për të Drejtat Rome, Dorëzimi i *ERRC e përbashkët për CEDAË-CRC Rekomandimet e përgjithshme / Komente për praktikën e dëmshme: Martesa e fëmijëve tek romët*, shtator 2011, p. 3, <http://www.errc.org/cms/upload/file/cedaw-crc-child-marriages-submission-9-sept-2011.pdf>



## Leonora

Leonora është një 16 vjeçare rome Elbasan, qytet i Shqipërisë së mesme. Ajo ka një vëlla më të vogël, aktualisht 13 vjeç, dhe dy më të rriturit, një vëlla dhe një motër janë të martuar dhe jetojnë me familjet e tyre. Ajo jeton me gjyshërit dhe familjen e xhaxhait në një shtëpi më dy dhoma e mbipopulluar, të cilën po e zgjeronin gjatë kohës së kërkimit prandaj familja e madhe flinte jashtë.

Kur Leonora ishte ende foshnjë prindërit e morën atë dhe fëmijët e tjerë me vete në Greqi ku jetonin herë pas here ndër vite dhe ku fëmijët i detyronin të lypnin dhe të riciklonin mbetjet e rrugës. Në 2004 prindërit u ndanë dhe u kthyen me fëmijët në Shqipëri. Kur i takoi Tdh në prill 2015 Leonora foli për Greqinë dhe ndarjen e prindërve si një nga gjërat që e kishte lënduar më shumë: "Atje lypja dhe mami na çonte tek koshat e plehrave. Ishte torturë. Pastaj mami dhe babi na prunë këtu. Nuk dua të kthehem më kurrë. As nuk dua ta kujtoj atë vend."

Kur u kthyen në Elbasan u zhvendosën tek gjyshërit nga babai të Leonorës. Babai kishte shkuar përsëri në Greqi. Shumë pak më pas i braktisi edhe mamaja për të shkuar në Itali. "Kur erdhën përsëri në Shqipëri ishte edhe më keq. Mamaja nuk dinte si të nxirrte para dhe rrinim pa ngrënë. Nuk i njihnim kushërinjtë e babait dhe nuk ndjeheshim mirë atje. Mami na la dhe atyre s'ju bëhej vonë për ne, na linin në një dhomë të ftohtë me një batanije të katër. Gjyshërit na jepnin bukë vetëm njëherë në ditë dhe na nxirrnin të mblidhnim kanaçe."

Më pas, gjyshërit nga ana e mamasë së Leonorës vendosën t'i merrnin fëmijët në shtëpi. Kushtet te k shtëpia e gjyshit nuk ishin shumë të mira dhe fëmijëve ju duhet të punonin sërish bashkë me pjesën tjetër të familjes të shisnin rroba të përdorura. Fëmijët shkonin tek Qendra Komunitare rome

Leonora duke parë jashtë dritares tek Qendra Komunitare Rome në Elbasan, Shqipëri

në 2006 kur i identifikoi stati Tdh-së për herë të parë gjatë një kampi veror në Elbasan. Sipas një punonjësi të Tdh-së që kishte punuar për rastin e tyre, “kur u identifikuan dukeshin të neglizhuar, familja nuk ju kishte plotësuar nevojat emocional dhe të rritjes. Kishin të gërvishtura në duar dhe fytyrë si rezultat i punës në rrugë.”

Kur u hap për herë të parë NjMF e Elbasanit në 2006, Tdh-ja i referoi rastin. PMF-ja tha se ishte fokusuar të ofronte masat e nevojshme të sigurisë që fëmijët të mos ishin në rrezik trafikimi apo që të riktheheshin në situatë rruge përsëri. Duke punuar me aktorë të tjerë në bashki dhe të Tdh-së, përgatitën një plan që synonte integrimin në shkollë të fëmijëve, i regjistruan në shkollë dhe tek aktivitetet e Qendrës Komunitare Rome dhe mbështetën gjyshërit e Leonorës me aktivitete për nxjerrje të ardhurash.

Punuan edhe me gjyshërit për ti ndihmuar të përmirësojnë ambientin në shtëpi dhe Leonora me vëllezërit të ishin të sigurt atje. Shkonin rregullisht në shkollë dhe tek aktivitetet e qendrës komunitare rome. “Gjithçka dukej shumë mirë. Shkonim në qendër dhe mësonim, por dhe në shkollë,” shpjegoi Leonora. Por, në verën e 2013 ngeli në klasë të gjashtë. Kur filloi përsëri shkolla në shtator ajo ishte 13 vjeçe dhe vendosi ta linte shkollën: “Nuk më vinte mirë të vazhdoja, duhet të përsërisja të njëjtën klasë.” Leonora do të ishte më e madhe se fëmijët e tjerë dhe i vinte turp të vazhdonte. Veç kësaj, PMF na tha se sipas mentalitetit të komunitetit romë ajo ishte ‘e rritur’ për shkollë dhe mbase për shkak të kësaj nuk do të ishte rehat me bashkëmoshatarët.

Në tetor 2013, Leonora dhe vëllai i vogël shkuan me xhaxhain dhe familjen e tij në Lazarat, një fshat në jug të Shqipërisë ku punonin me mijra punëtorë sezonalë, përfshirë romët e varfër, që mbillnin, krasisnin dhe paketonin kanabis. Një studim i UNICEF dhe Save the Children tregonte se për të njëjtën periudhë ishin identifikuar 2,359 fëmijë që punonin për kultivimin e kanabisit në Lazarat.<sup>14</sup> Sipas PMF-së gati 20 fëmijë nga Lazarati, përfshirë edhe vëllain e vogël të Leonorës kishin braktisur shkollën dhe shkonin për të punuar në Lazarat. E alarmuar nga situata, PMF-ja mbledhi grupin multi-disiplinar për të hartuar një plan veprimi për këta fëmijë. Menjëherë njoftuan policinë pasi ishte situatë emergjente, sepse i vendoste fëmijën në rrezik trafikimi. Ata përfshinë edhe sektorin e edukimit në bashki për të siguruar se kur të ktheheshin fëmijët, do të kishin mundësi të shkonin përsëri në shkollë. Përfaqësuesi nga bashkia e Elbasanit i dërgoi një letër Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) për t’i informuar. Megjithatë, sipas PMF-së nuk ishte marrë asnjë masë nga autoritetet e qeverisë vendore për t’i hequr fëmijët nga kjo situatë e rrezikshme dhe fëmijët u kthyen bashkë me familjet në nëntor, kur mbaroi sezoni.

“Nuk e kisha idenë sa keq do të ishte atje. Kur shkuam ngela pa fjalë. Kushtet ishin shumë keq; flinim në kasolle. Kishte hashash dhe duhet të pastronim bimët dhe merrnim 1,000 Lek per kile,” shpjegoi Leonora. “Zgjoheshim në tre të mëngjesit dhe ktheheshim në 8 të darkës dhe njerëzit flinin menjëherë, as nuk laheshin. Shumë shpesh ishim kaq të lodhur sa na zinte gjumi. Pronarët bërtisnin ‘zgjohuni, mos flini se nuk ju paguajmë.’ Kishte shumë fëmijë të moshës time atje; i përdornin prindërit për të bërë para. Më e vështira ishte era; sikur kishim pirë, si budallenj; qeshnim, këndonim... na drogonte era. Mua më dhimbte shumë koka.” Mediat vendase dhe të huaja e kishin raportuar situatën për kushtet e punës në Lazarat ku me qindra persona u sëmurën për shkak të punës në fushat me kanabis.<sup>15</sup>

14 UNICEF dhe Save the Children, *Studim Kombëtar për fëmijët në situatë rruge në Shqipëri*, fq.45

15 Reuters, “Me qindra punëtorë të kanabisit sëmuren në fshatin shqiptar”, 1 nëntor 2013, <http://www.reuters.com/article/2013/11/01/us-albania-cannabis-idUSBRE9A00K020131101>



## Puna tek fëmijët


*Puna tek fëmijët ju referohet "fëmijëve që bëjnë punë të rrezikshme dhe fëmijëve të cilët për shkak të moshës ose orëve të punës mendohet se përballen me rreziqe të ndryshme për shkak të ndikimit që ka punësimi tek zhvillimi i tyre fizik, social, psikologjik ose arsimor"<sup>16</sup> Neni 32 i KDF-së kërkon që shtetet palë të njohin të drejtat e fëmijëve për mbrojtje nga shfrytëzimi ekonomik dhe punët e rrezikshme, por edhe nga punërat që ndikojnë tek edukimi fëmijës.*

*Sipas një studimi të Institutit Shqiptar të Statistikave (INSTAT) dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO), afërsisht 54,000 fëmijë, 7.7 përqind e fëmijëve në Shqipëri midis moshave 5 dhe 17 vjeç kanë punuar në 2010, shpesh përtej aftësive të tyre. Fëmijët punojnë në bujqësi, përfshirë kultivimin e kanabisit, por edhe në punë të tjera si në miniera, punë shtëpie apo që kryejnë aktivitete në rrugë, përfshirë lypjen. Në 2010 afërsisht 35,500 fëmijë konsiderohen si fëmijë punëtorë në Shqipëri.<sup>17</sup>*

16 Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) dhe Instituti i Statistikave (INSTAT) i Republikës së Shqipërisë, *Fëmijët që punojnë tek Republika e Shqipërisë: Rezultati i sondazhit kombëtar të vitit 2010 për fëmijët që punojnë*, korrik 2012 fq. 26 <http://www.doh.gov/alba/reports/pdf/GL0%2008%20Albania%20NCL3%202012.pdf>

17 ILO dhe INSTAT, 2012, fq. 10





Kur u kthyen në Elbasan, vëllai më i vogël i Leonorës u kthye në shkollë, por Leonora nuk deshi të kthehej. Sipas PMF-së, Qendra Komunitare Rome ishte përpjekur shumë që ta bindnin të kthehej në shkollë por nuk ja dolën mbanë. “Kur përpiqeshin ta bindnin të shkonte në shkollë ajo nuk shkonte më as në Qendrën Komunitare Rome. Kur nuk përpiqeshin më ajo filloi të shkonte përsëri tek aktivitetet e Qendrës.” Leonora është shumë aktive dhe këshillon edhe fëmijët e tjerë. Kur e pyesin nëse e ndimoi ndokush pasi u kthye nga Lazarati, Leonora u përgjigj: “Jo. Por unë kam ndihmuar fëmijë. Kam qenë në një trajnim për bashkëmoshatarët për fëmijët që ishin kthyer nga Greqia. Kam ndihmuar ca fëmijë, jo shumë.”


Kthimi saj nga Lazarati ishte shumë i vështirë siç na shpjegoi: “Kur punoja atje isha e zënë dhe e kisha harruar jetën time, ato që kisha kaluar. Tani që u ktheva m’u kthyen hallet. Tani kujdesem për vëllain; e bëj gati për shkollë dhe bëj punët e shtëpisë.” Leonora na tha që nuk shqetësohet për veten aq sa shqetësohet për të tjerët: “Asnjë ëndërr nuk kam për vete, vetëm për vëllain; të ketë një shtëpi, punë dhe të mos punojë në rrugë.

Vajzat martohen dhe shkojnë tek burrat, por vëllai mund të ngelet në rrugë.” Leonora e pranoi që jeta është më e vështirë për vajzat sesa për djemtë: “Po të përdhunuan kush do kujdeset për ty? Ajo tha se kishte shumë raste vajzash që i përdhunonin, por asnjë nuk kujdesej për ato.

“Unë e di se ku mund të shkoj të kërkoj ndihmë, por dhe po shkova çfarë do të ndodh pastaj? Unë e bëj, por nuk më dëgjojnë...”

ka njerëz që punojnë për të mbrojtur fëmijët por nuk duan prindërit. [Në fillim] të dëgjojnë, pastaj bëjnë njësoj. Është mentaliteti.”

Megjithëse janë marrë disa masa nga institucionet dhe OJQ-të në Elbasan që ta mbrojnë Leonorën, ato kanë qenë të fokusuar për ta hequr nga rruga. E braktisur nga prindërit ajo ka qenë në kujdesin e të afërmeve por që mesa duket ka qenë disa herë në rrezik prej tyre; cilado masa të kenë marrë autoritetet as e kanë mbrojtur nga shfrytëzimi dhe as nuk e kanë garantuar por ajo duke qenë një vajzë e shkathët dhe e zgjuar ka arritur të zhvillojë potencialin e saj të plotë duke vazhduar edukimin. Edhe pse ka shumë potencial, mundësia e vetme për zhvillimin personal duket se janë aktivitetet tek Qendra Komunitare Rome, por që bën më shumë se çdo të bënin vajza të ngjashme në të njëjtën situatë. Por, në një mjedis larg prej mbrojtjes, duke mos qenë në shkollë, Leonora mund të kishte qenë edhe më vulnerabël.



*Leonora ndan përvojën e saj mbi shërbimet e mbrojtjes dhe përkrahjes gjatë takimit tek Qendra Komunitare Rome në Elbasan, Shqipëri, prill 2015*



## Ardi

Ardi është një djalë 16 vjeç, nga një familje e varfër, nga një familje shqiptare në S., një fshat i vogël në juglindje të vendit. Ai është i parafundit nga pesë fëmijë. Ardi ka humbur të atin kur ishte dy vjeç. Shumë kohë më pas, e ëma Marsela e futi në një institucion rezidencial pasi kishte vonesa në zhvillim dhe kishte nevojë për përkrahje që nuk mund ta merrte në shtëpi. Pas vdekjes të së shoqit, Marsela kishte vështirësi financiare dhe filloi të jetonte me një mashkull tjetër B., tek një fshat tjetër afër. Pensioni i partnerit të ri e ndihmonte që të ushqente fëmijët. Ajo e mori përsëri Ardin në shtëpi me B. kur ishte tetë vjeç.

Nga fundi 2010, një djalë më i rritur në fshat që kishte lidhje me familjen filloi ta abuzonte seksualisht Ardin kur ishte 12 vjeç. Kur e takoi Tdh-ja, Ardi tha se i kishte treguar mamasë për abuzimin pas herës së tretë: “Nuk i thashë që në fillim se do ndjehej shumë keq.” Marsela ndërhyri duke folur me mamanë e djalit duke qenë se kishte lidhje midis familjeve dhe kishte frikë se nuk do ta besonte njeri po të shkonte në polici. Fatkeqësisht, gjërat nuk ndryshuan për Ardin. Djali e abuzoi sërish seksualisht bashkë me një shok. Kur Marsela e gjeti Ardin duke qarë dhe me dhimbje dhe mori vesh që e kishin përdhunuar përsëri, vendosi të shkonte në polici.

Policia e zonës mori menjëherë masa, intervistuan Ardin dhe të ëmën në prani të psikologut të një shkolle dhe e dërguan Ardin për ekzaminim mjekësor tek një ekspert. Kur e intervistoi Tdh në Prill 2015, Ardi, mbante mend që oficeri policisë i kishte thënë: “Po pse erdhi tek ti ai [abuzuesi]? Nuk kishte vajza?” Sipas Ardit dhe mamasë, mjeku ligjor kishte bërë ekzaminimin dhe i kishte dhënë ilace, por nuk ja kishte mjekuar plagën. Çështja bëri bujë në media duke ekspozuar të dhëna personale të Ardit, por tërhoqën edhe vëmendjen e OJQ-ve të cilat filluan të merrnin masa për të ndjekur rastin.

Meqë nuk kishte NJMF në atë zonë, Tdh-ja njoftoi Shërbimin Rajonal Social Shtetëror, i cili bashkërisht me Tdh-në dhe inspektorin e policisë bënë një vizitë në familje për të vlerësuar situatën e djalit. Ardi kishte të nxira dhe plagë në trup dhe kushtet shëndetësore dhe psikologjike ishin të rënduara. Duke qenë se nuk kishte qendër emergjencash, Ardi ishte akoma në fshat; ishte i tmerruar dhe nuk dilte nga shtëpia. Familjes i bënin presion familjarët e të dyshuarit që të tërhiqnin

Ardi tek shtëpia e tij tek fshati S., Shqipëria juglindore, prill 2015



akuzat. E gjithë familja ishte e ekspozuar, stigmatizuar dhe në presion të madh nga komuniteti vogël në fshat. Ardi dhe mamaja kërkuan të largoheshin me urgjencë nga fshati. Nëpërmjet Tdh-së, OJQ-ja në Elbasan "Another Vision" (*Tjetër Vizion*), e cila kishte eksperiencë në ofrimin e përkrahjes për fëmijët që kishin vuajtur nga abuzimi seksual, i ofruan një ambient Ardit dhe Shërbimi Rajonal Social Shtetëror mori të gjitha masat që ai të vendosej atje.

Ardi ishte ende shumë i traumatizuar kur shkoi në Elbasan. Një punonjës social i Tjetër Vizion kujton "ai nuk flinte, kishte makthe, ishte i frikësuar dhe në ankt, ndonjëherë edhe agresiv." Tjetër Vizion i kërkoi NJMF-së aty të ofronte ndihmë me shërbime të tjera për të përfunduar ndërhyrjen. Prioritet ishte mirëqenia e Ardit dhe të ndjehej i sigurt në institucion kështu që i ofruan trajtim psikologjik me mbështetjen e OJQ-së. Ardi filloi të krijonte besim gradualisht, krijoi marrëdhënie të ngushtë me stafin dhe gjeti një mjedis të sigurt tek Tjetër Vizion.

Tdh kishte nënkontraktuar që në fillim OJQ "Klinika Ligjore për të Mitur" që të punonte me rastin e Ardit. Klinika ofroi këshillim ligjor dhe psikologjik për Ardin që në fillim dhe përgajtë gjithë procesit ligjor kundër abuzuesve. Në Dhjetor 2011, abuzuesit u dënuan me burgim.

Sipas PMF-së Elbasan, gjatë gjysmës së dytë të 2012, *Tjetër Vizion* i mbaruan fondet dhe qendra duhet të ndëpriste shërbimet. PMF-ja thirri grupin multi-disiplinar për të diskutuar alternativat e mundshme për Ardin. Nuk do të kishte qenë e përshtatshme të kthehej në fshat, prandaj Tdh-ja mbështeti financiarisht qëndrimin e tij tek qendra Tjetër Vizion. Megjithatë, në fund të vitit shkollor në Qershor 2014, pas një vendimi të përbashkët nga Shërbimi Social Rajonal dhe Tjetër Vizion, dhe kundër dëshirës së tij, Ardin e kthyen tek familja në S. Pasi ishte më i sigurt për të dhe vëllezërit e tij. Një nga punonjësit e Tjetër Vizion shpjegoi se vendimi ishte mbështetur tek rëndësia që kishte fakti që Ardi të bashkohej me familjen në vend që ta kalonte kohën në institucione.

PMF-ja në Elbasan shprehu shqetësimin se ky ishte një rast që e menaxhonte ajo dhe nuk kishte qenë pjesë e vendimit të transferimit dhe ishte informuar vetëm kur Ardi ishte kthyer me familjen. Kthimi i Ardit tek fshati S. nuk ishte në interesin më të lartë të tij, pasi në zona rurale nuk kishte shërbime mbështetëse pasi vuante akoma nga probleme shëndetësore dhe emocionale. Veç kësaj, komuniteti është shumë i vogël dhe të gjithë e dinin historinë e tij. Në fakt, Ardi e theksoi se nuk kishte dashur të kthehej në fshat se familja e tij është e varfër dhe jo vetëm që ju mungonte mbështetja, por i duhej të përballej edhe me të shkuarën traumatike. "Më ngacmojnë në shkollë. Kur ma thonë në fshat atë që më ka ndodhur mërzitem shumë. Shkoj në xhami dhe tek liqeni dhe përpiqem ta harroj, por se harroj dot."

Kur u zbulua abuzimi, Ardin e larguan nga mjedisi dëmshëm, e çuan në vend të sigurt dhe i ofruan përkrahje për t'u shëruar. Por kur përfunduan fondet e OJQ-së dhe nuk mund të qëndronte më në qendër, u vendos si e mirëqenë e ardhmja e Ardit dhe u ngrit pyetja sesa e qëndrueshme ishte mbrojtja e tij. Ai u kthye në një mjedis i cili e ekspozonte ndaj vështirësive, varfërisë së madhe dhe stigmës, për të mos thënë edhe në një rrezik më të madh. Dhe si edhe me shumë fëmijë të tjerë në zonat rurale të Shqipërisë, të cilëve ju ishin marrë vesh historitë, Ardi nuk do të kishte akses tek shërbimet sociale dhe të kujdesit për të cilat kishte nevojë.



## Mbijetesa nga dhuna seksuale

Dhuna seksuale ndaj fëmijëve është një shkelje e madhe e të drejtave të tyre. Mund të ndodh në forma të ndryshme, si abuzim seksual, ngacmim seksual, përdhunim apo shfrytëzim seksual për prostitucion ose pornografi. KDF-ja e ndalon dhunën seksuale ndaj fëmijëve.<sup>18</sup> Neni 39 i KDF kërkon që shtetet palë të “marrin të gjitha masat e duhura për të promovuar rikuperimin psikologjik dhe reintegrimin e fëmijës viktimë të...abuzimit” dhe parashikon që ky rikuperim dhe riintegrim të kryhet në një mjedis që promovon shëndetin, vetë-respektin dhe dinjitetin e fëmijës.” Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunën në familje (Konventa e Stambollit), e cila është ratifikuar nga Shqipëri në Shkurt të 2013 dhe ka hyrë në fuqi në gusht 2014, kërkon që shtetet palë të marrin masat e nevojshme ligjore dhe të tjera për të mundësuar qendrat e referimit të përshtatshme dhe të lehta për t’u aksesuar për viktimat e përdhunimit dhe dhunës seksuale, të cilat duhet të jenë në një numër të mjaftueshëm për të garantuar ekzaminim mjekësor dhe ligjor, mbështetje për traumën dhe këshillim për viktimat.”<sup>19</sup>

Sipas OJQ-së dhe autoriteteve në nivel qendror dhe vendor, një nga dobësitë kryesore të mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri është ofrimi i përkrahjes efektive të fëmijëve të mbijetuar nga dhuna seksuale. Mungesa e shërbimeve të emergjencës, ekspertizës dhe përvojës së psikologëve dhe profesionistëve të tjerë që punojnë me fëmijët të mbijetuar nga dhuna seksuale, është një nga mangësitë më të mëdha. Drejtori Agjencisë Shtetërore pranoi se “kjo është një pikë shumë e dobët; po dështojmë sistematikisht”, por theksoi se Agjencia i ka dhënë përparësi kësaj pike.

<sup>18</sup> CRC, Art. 34

<sup>19</sup> Konventa e Këshillit të Evropës mbi parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunën në familje CETS No.: 210, Art. 25, gjendet tek: <http://conventions.coe.int/Treaty/EN/Treaties/Html/210.htm>



## Fëmijët në kujdes institucional

KDF, Neni 9 kërkon që shtetet palë "të garantojnë se fëmija nuk do të ndahet nga prindërit kundër dëshirës së tij, përveç rastit kur autoritetet kompetente, në bazë të rishikimit gjyqësor vendosin që, në përputhje me ligjin dhe procedurat përkatëse, kjo ndarje është e nevojshme për interesin më të lartë të fëmijës..." dhe "të gjitha palët e interesuara duhet të kenë mundësinë të marrin pjesë në diskutim dhe të bëjnë të njohura mendimet e tyre." Neni 18(2) më tej parashikon: "Shtetet palë u japin ndihmën e duhur prindërve dhe kujdestarëve ligjor të fëmijës, në ushtrimin e përgjegjësisë që ju atyre për rritjen e fëmijës dhe sigurojnë ngritjen e institucioneve, qendrave ose shërbimeve të kujdesit të fëmijës." Rekomandimi (2005) i Komisionit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi të drejtat e fëmijëve që jetojnë në institucione rezidenciale, thekson se prindërit kanë përgjegjësinë parësore për rritjen dhe zhvillimin e fëmijëve dhe theksojnë se ndarja e fëmijëve nga familja duhet të jetë zgjidhja e fundit dhe duhet të bëhet vetëm kur është e pashmangshme dhe një masë e përkohshme. Shteteve palë ju kërkohet të identifikojnë zgjidhje që mbështeten tek familja për të adresuar shkaqet rrënjësore të ndarjes së familjes dhe të garantojnë kontaktin midis prindërve dhe fëmijëve.<sup>20</sup>

Aktualisht ka 24 institucione rezidenciale dhe tet Qendra Zhvillimi në Shqipëri, një kombinim i institucioneve publike me ato private, të cilat ofrojnë kujdes rezidencial për fëmijët nën 18 vjeç të cilët janë jetimë, të braktisur ose nuk kanë kujdes prindëror të përshtatshëm. Sipas një sondazhi të kryer së fundmi nga UNICEF dhe MMSR-së, fëmijët romë përfaqësojnë 18 përqind të fëmijëve në institucione publike dhe private në Shqipëri, nga janari 2013 deri në korrik 2014, një përqindje e lartë po të krahasosh përqindjen e popullsisë romë me popullsinë totale në Shqipëri. Fëmijët romë përbënin 40 përqind të numrit të fëmijëve në këto institucione. Përqindja e fëmijëve të etnisë shqiptare dhe atyre egjiptiane ishte përkatësisht 77 dhe 5 përqind përkatësisht. Sondazhi tregoi edhe se një numër i madh fëmijësh nuk ishin as të braktisur dhe as jetimë, por vendosja e tyre në institucione ishte si rezultat i gjendjes sociale dhe ekonomike.<sup>21</sup>

20 Këshilli Evropës, Komiteti Ministrave, Rekomandime (2005)5 të Komisionit të Ministrave të Shteteve Anëtare mbi të drejtat e fëmijëve që jetojnë në institucione rezidenciale (16 mars 2005), gjendet tek: <https://wcd.coe.int/wcd/ViewDoc.jsp?id=835953&Site=CM>

21 Peter Evans with NGO Future Centre, Shqipëri, *Sondazh për fëmijët që banojnë në institucione publike ose private rezidenciale në Shqipëri* [http://www.unicef.org/albania/2014-Albania\\_stock\\_flow\\_analysis\\_report\\_ver3.pdf](http://www.unicef.org/albania/2014-Albania_stock_flow_analysis_report_ver3.pdf)



Që prej 2005 – në përputhje me standardet ndërkombëtare, ligjet e BE-së dhe trendet e politikave, Qeveria shqiptare ka identifikuar si një nga parimet themelore të reformës së shërbimeve sociale, deinstitutionalizimin e kujdesit, sidomos për fëmijët. Supozohet se do të kërkohen alternativa të tjera që të zëvendësohet vendosja në institucione me birësime, kujdesi nga të afërmit e ngushtë ose grupime në shtëpi në formën e familjes. Një projekt pilot për kujdesin birësues për fëmijët pa prindër nisi në 2010.<sup>22</sup> Është interesante të shikosh se, sipas një sondazhi të fundit të UNICEF dhe MMSR-së, vetëm 3 nga thujase 1,000 fëmijë kanë marrë kujdes birësues për periudhën e mbuluar nga sondazhi. U raportua se 88 fëmijë u kthyen tek familjet biologjike dhe 59 u adoptuan.<sup>23</sup> Megjithatë, një përfaqësues i departamentit të Shërbimeve Sociale Shtetërore nga MMSR tha se që të funksionojë deinstitutionalizimi, duhet të ketë shërbime komunitare jo rezidenciale, që për momentin mungojnë gjerësisht në Shqipëri.

22 Irene Stevens, Graham Connelly and Ian Milligan, Të ecësh përpara me kujdesin alternative, Vlerësimi mbi projektin pilot në Shqipëri për kujdesin birësues, Shtator Tetor 2013, fq. 10, [http://www.unicef.org/albania/Protection-Albania\\_fostering\\_evaluation-oct13.pdf](http://www.unicef.org/albania/Protection-Albania_fostering_evaluation-oct13.pdf)

23 Peter Evans with NGO Future Centre, Shqipëri, *Sondazh për fëmijët që banojnë në institucione publike ose private rezidenciale në Shqipëri* [http://www.unicef.org/albania/2014-Albania\\_stock\\_flow\\_analysis\\_report\\_ver3.pdf](http://www.unicef.org/albania/2014-Albania_stock_flow_analysis_report_ver3.pdf)



Dhoma e Ervinit tek konvikti për jetimët të cilët kanë dalë nga institucionet rezidenciale në Tiranë, Shqipëri, prill 2015

Ervini është një djalë romë 16 vjeç. Kur ishte dy vjeç e braktisi e ëma bashkë me vëllain më të rritur dhe iku në Shtetet e Bashkuara. I ati i Ervinit, i detyronte fëmijët të lypnin dhe më pas i vendosi tek një institucion fetar rezidencial në Tiranë 'Fëmijët e tij', të cilin e drejtonte një shtetas britanik. Ervini ishte shtatë vjeç kur plasi skandali në Maj 2006, kur u ngritën akuza se stafi misionar dhe dy britanikë të tjerë kishin abuzuar seksualisht me fëmijët në qendër. Policia e mbylli qendrën. Dhjetë fëmijë, nga mosha katër deri në 13 vjeç, dëshmuar se ishin abuzuar seksualisht nga stafi.<sup>24</sup> Shërbimet sociale shtetërore e vendosën Ervinit dhe fëmijët e tjerë të qendrës tek një jetimore në Tiranë. Vëllai i madh i Ervinit shkoi tek gjyshja nga nëna dhe daja në Elbasan.

Tdh-ja kontrakttoi Klinikën Ligjore për të Mitur të ofronte këshillim psikologjik, trajtim dhe përkrahje ligjore për fëmijët e abuzuar. Psikologjia klinikës kujton "fëmijët ishin në një situatë dramatike." Ervini ishte abuzuar disa herë seksualisht dhe sipas saj, "ai ishte një nga fëmijët më të traumatizuar. Kishte shumë probleme psikologjike dhe pasoja nga trauma. Për muaj të tërë nuk flinte dot me dritat fikur. Por, të gjithë fëmijët kishin probleme dhe ishin agresivë." Fëmijët morën këshillim psikologjik dhe Klinika ishte në krahun e tyre për t'i ndihmuar gjatë procesit të gjatë ligjor. Pas një gjyqi të gjatë misioneri britanik u dënua në Nëntor të 2008 me 20 vjet burgim. Dy pjesëtarët e tjerë të stafit të përfshirë në abuzim seksual u dënuan përkatësisht me 20 dhe 15 vjet burgim në Janar 2010."<sup>25</sup>

Babait ju hoq kujdestaria ligjore e Ervinit dhe u dërgua në institucion. Punonjësit social të jetimores raportuan se punuan me Ervinit dhe fëmijët e tjerë që erdhën nga shtëpia "Fëmijët e tij" për t'i ndihmuar të rikuperoheshin. Stafi psikologjik i jetimores tha se, duke pasur parasysh situatën e tij, Ervini po bashkëpunonte mirë dhe fëmijët e tjerë tregonin se kishte progres. Në fakt, Tdh-ja e intervistoi në maj 2015, dhe Ervini e kujtonte me nostalgji kohën në jetimore dhe tha se ishin vitet më të bukura të jetës së tij. Ai futej në telashe ndonjëherë në institucion dhe në

24 Daily Mail, "Burgosen dy britanik për abuzim me të mitur në jetimore në Shqipëri", 13 Janar 2010, <http://www.dailymail.co.uk/news/article-1242767/Two-Britons-jailed-abusing-children-orphanage-Albania.html>

25 Daily Mail, "Dy britanikë burgosen për abuzimin e fëmijëve në jetimore në Tiranë, 13 janar 2010, <http://www.dailymail.co.uk/news/article-1242767/Two-Britons-jailed-abusing-children-orphanage-Albania.html>



shkollë, por problemet u shtuan më shumë kur ishte 15 vjeç. Sipas stafit psikosocial të jetimores: “Ervini ka nevojë të jetë i lirë dhe jashtë institucionit, që është normale për një adoleshent; por ka dhe nevojë për sigurinë që i ka munguar; këtu ju plotësuan nevojat bazë, gjeti mbështetje dhe siguri, por nga ana tjetër do të jetë si të gjithë adoleshentët, të dal, të pij cigare...”

Gjatë qëndrimit të tij në jetimore, Ervini kishte mbajtur kontakte me familjen e dajës në Elbasan. Duke pasur këtë parasysh si dhe aftësitë dhe zotësitë e Ervinit, kur mbaroi klasën e nëntë në verën e 2014, stafi jetimores vendosi ta regjistronte tek shkolla e mesme mekanike në Elbasan. Ervini tha “Në fillim bëra pushimet verore. Pata një keqkuptim me dajën dhe nuk më donte më. Duhet të bëja provimet e shkollës në shtator kështu që (jetimorja) më dërgoi në konvikt në Elbasan. Shpresoja se familja ime do kujdesej për mua dhe mendova se do isha më mirë atje, por doli më keq.”

Fjetja dhe ushqimi në konvikt mbulohehin nga bashkia e Elbasanit pasi ishte bërë një marrëveshje me jetimoren, e cila i jepte edhe 1,000 Lek në muaj para xhepi dhe i blenin librat, materialet shkollore dhe rrobat. Megjithatë, nuk kishte asnjë lloj mbështetje psikosociale apo përkrahje efektive. Ervini nuk shkonte rregullisht në shkollë dhe nuk i pëlqente të jetonte në konvikt. “ndonjëherë mirë ishte, por nuk jam mësuar larg nga Tirana. Nuk shkoja fare në shkollë.” Një psikolog i ri që punonte në konvikt tha se Ervini e kishte të vështirë të zbatonte rregullat e rrepta të konviktit, që nuk të jepnin shpesh mundësi të vizitoje familjen apo të shikojë aktivitete jashtë si ndeshje futbolli. Në të njëjtën kohë stafi konviktit pranoi se nuk kishte aktivitete apo programe për kohën e lirë të të rinjve: “Nuk kemi programe argëtimi në konvikt dhe po të duam të organizojmë diçka nuk kemi para për gjëra të tilla.”

Sipas psikologut, Ervini kishte probleme serioze me sjelljen, por ishte e vështirë të merreshe me të pasi nuk kishin dijeni për të shkuarën dhe historinë e Ervinit, pasi jetimorja nuk ju kishte thënë asgjë për të shkuarën e tij kur e sollën për herë parë në Elbasan. Ervini e pranoi: “Fillova të vidhja, çfarë të bëja papunë? Tani jam i rritur dhe 1,000 lek në muaj nuk më dalin. Çunat e tjerë dilnin, pinin kafe. Unë rrija vetëm atje. Vodha për para, më duheshin para.” Psikologu theksoi se, “edhe pse kemi folur shumë dhe e kemi këshilluar, i kemi kërkuar të mos i përsërisë, nuk më dëgjo. Por, tha, problemi nuk filloi këtu në Elbasan, ai erdhi me probleme (nga jetimorja).” Stafi konviktit pohoi se kur kishte filluar ta shfaqte këtë sjellje Ervini, nuk kishin kërkuar mbështetje as nga NJMF dhe as nga aktorë të tjerë në Elbasan.

Sipas psikologut të konviktit, në mars 2015, Ervini vodhi disa kompjutera nga një zyrë në Elbasan dhe policia erdhi tek konvikti të flisnin me të. Ervini kujton: “oficeri policisë më tha të ikja. Po mos të ikja do të më arrestonte. Kështu që, erdha prapë në Tiranë.” Pak a shumë në të njëjtën kohë, jetimorja kishte marrë një letër nga shkolla e Ervinit në Elbasan, të cilët e informonin se ishte përjashtuar për shkak të mungesave. Ervini ishte kthyer tek jetimorja dhe kishte kërkuar për një vend ku të rrinte, por i thanë se nuk mund të qendronte më atje. Drejtori tha se ishin në dijeni për sjelljen e tij dhe “mendua se ishte gjëja më e mirë për Ervinin dhe fëmijët e tjerë po të rrinin në konvikt” ku dërgoheshin fëmijët me statusin jetim pasi largoheshin nga jetimorja. Ervini i ofruan një vend atje dhe ushqim falas në jetimore. Kushtet e konviktit të Tiranës ishin shumë të këqija, ndërtesa ishte e amortizuar dhe gati 60 veta ndanin dy banjo, një për burra dhe një për gra. Ervini ishte një nga dy të miturit që jetonin atje. Ai e ndante dhomën me dy burra tek të dyzetat dhe Tdh-ja u informua nga banorët e tjerë se kishte fare pak supervizim, për të mos thënë aspak, pasi kujdestari nuk ishte shpesh i pranishëm.

Në prill 2015 stafi Tdh identifikoi Ervinin në situatë rruge bashkë me një shok. Djemtë thanë se flinin tek një ndërtesë afër një llotoje në një zonë të vështirë të Tiranës. Duke qenë se Ervini nuk donte të qëndronte në konvikt, Tdh njoftoi NJMF-në Tiranë dhe Ervini bashkë me shokun u vendosën për disa ditë tek qendra

e emergjencës së ARSIS-it. Një përfaqësues i Task Forcës nga Agjencia shtetërore kërkoi mbledhjen urgjente të grupit multi-disiplinar. U diskutuan mundësi të ndryshme, megjithatë para se ndonjëri prej këtyre planeve të vihej në zbatim, Ervinin e arrestoi dhe e mori policia e Elbasanit. Kujdestari ligjor i jetimores për Ervinin i tha Tdh-së se nuk kishin marrë asnjë njoftim zyrtar nga policia dhe shtoi se e morën vesh vetëm sepse lajmi doli në lajme.

Ervini kujton se bashkë me shokun ju afrua policia e Elbasanit. “më vuri prangat dhe më tha se kemi ca punë të pambaruara’ dhe më çuan në Elbasan. U habita. Kisha një muaj që kisha ikur nga Elbasani. Më morën në pyetje për një a dy orë. U sollën mirë; më futën ca pëllëmba, por s’ka gjë, i duroj unë.” Sipas Ervinit nuk pati as avokat dhe psikolog të pranishëm kur e mori në pyetje policia. “Ndenja një natë aty dhe të nesërmen më morën prapë në pyetje dhe më treguan videon nga kamerat e sigurisë së zyrës. Pastaj më çuan në paraburgim. Atje ndenja katër pesë ditë.” Ervini tha se i caktuan avokat. “Ai më tha çfarë të thoja. Të tregoja që vodha se më duheshin lekët dhe e takova të nesërmen në mëngjes. Më tha se do më ndihmonte. E takova tek gjykata Elbasanit. Më morën në pyetje. Nuk ju thashë ku i shita dhe më thanë pastaj se do më transferonin në Kavajë. I pyeta përse kohë? Më thanë është e pacaktuar...”

Ervini u transferua tek Instituti të Miturve në Kavajë, qendër ndalimi për autorët e mitur, në 28 Prill 2015. Në kohën kur e takoi stafi i Tdh-së në 18 maj 2015, askush, përfshirë edhe kujdestarin e tij ligjor të jetimores, nuk kishin kontaktuar me Ervinin. “Askush nuk e di që jam këtu, nuk njoftova dot njeri. Isha me (shokun tim) kur më kapën. Që atje më çuan tek Komisariati Policisë në Elbasan, por askush se dinte. Më mbajtën atje për pesë ditë dhe pastaj më sollën këtu.” Ervini tha se shumica e të rinjve në Kavajë ishin atje për vjedhje dhe ai i njihte shumë nga djemtë aty. Ervini i tha Tdh-së se shpresonte të mos qëndronte gjatë aty: “nuk kam asgjë këtu, vetëm këto rrobat, me këto isha kur më arrestuan. Nuk rri dot këtu, nuk rri dot brenda mbyllur.”

Rasti i Ervinit nuk është i rrallë. Në fakt, është një djalë tipik që ka jetuar jetën në institucione vetëm për të përfunduar në kufijtë e shoqërisë dhe në konflikt me ligjin. Rasti i Ervinit ilustron sesa inefektive mund të jenë ndonjëherë ndërhyrjet, kur institucionet punojnë në mënyrë të izoluar. Tdh-ja dhe organizatat e tjera janë të shqetësuara se shpesh drejtorët ose stafi rezidencial përgjegjës për kujdesin ose që kanë kujdestarinë ligjore të fëmijës, mund të marrin në mënyrë të njëanshme vendime që ndikojnë tek fëmija, pa e referuar tek struktura më të gjera të mbrojtjes si NJMF-ja apo organe të tjera përgjegjëse në nivelin qendror ose vendor. Fëmijët që largohen nga institucionet nën moshën 18 vjeç shpesh lihen totalisht pa supervizim dhe shumë shpesh kjo i ekspozon ndaj rrezikut, si për shembull përfundojnë në situatë rruge, rrezik nga trafikimi ose mund të bëjnë krime të lehta ose edhe më të rënda.



## Fëmijët në konflikt me ligjin

Neni 40 i KDF-së parashikon se “Shtetet palë i njohin çdo fëmije të dyshuar, të akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon te fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon tek ai ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar riintegrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj.” Më tej KDF-ja parashikon më në hollësi detyrimet e shteteve palë në këtë fushë që përfshijnë “siç janë kujdesi, orientimi dhe mbikëqyrja; këshillat; periodha e provës; kujdesi në familje; programet e edukimit të përgjithshëm dhe profesional dhe zgjidhje të tjera, veç atyre institucionale, për t’u siguruar fëmijëve një trajtim në përputhje me mirëqenien e tyre dhe në raport me gjendjen e tyre dhe me shkeljen e ligjit.”<sup>26</sup>

Aktualisht në Shqipëri, fëmijët në konflikt me ligjin janë shumë vulnerabël në sistemin gjyqësor dhe të përkrahjes sociale. Drejtësia miqësore për fëmijët që gjenden në konflikt me ligjin është e pamjaftueshme dhe ndonjëherë nuk ekziston fare. Sipas një studimi të autorizuar nga Tdh-ja, megjithë disa reforma në sistemin e drejtësisë

<sup>26</sup> KDF, Neni 40



për të mitur, mbeten ende mangësi strukturore, përfshirë edhe kuadrin e papërshtatshëm ligjor. Mungojnë udhëzimet për policinë në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut mbi arrestimin dhe hetimin e çështjeve që përfshijnë të mitur si dhe mungesa e ambienteve të përshtatshme dhe shërbimeve, të cilat e bëjnë gati të pamundur dënimin alternativ.<sup>27</sup> Bashkëpunimi midis institucioneve të kujdesit social, përfshirë NJMF-në dhe zyrtarë të zbatimit të ligjit, si policia dhe më me rëndësi prokurorët dhe gjykatësit, është shumë i varfër dhe shpesh problematik. Një studim nga Save the Children dhe Meridia Albania vëren “mungojnë mekanizmat ndërinstitucional për referimin e fëmijëve dhe të miturve në konflikt me ligjin nga Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale tek NJMF-të.” Krahas kësaj, studimi nënvizon se “ka mungesë të instrumentave ligjor mbrojtës që të garantojnë specifikisht të drejtat e fëmijëve dhe të të miturve në konflikt me ligjin, duke u fokusuar tek riintegrimi nëpërmjet edukimit, udhëzimeve dhe trajnimit profesional apo punësimit.”<sup>28</sup>

<sup>27</sup> Renate Winter dhe Peter Evans, për Terre des hommes, Misioni në Shqipëri, *Një kërkim në sistemin aktual mbi fëmijët në konflikt me ligjin në Shqipëri*, projekt raport, do të publikohet në 2015

<sup>28</sup> Save the Children dhe Meridia Albania, *Riintegrimi fëmijëve dhe të miturve në konflikt me ligjin dhe marrja përsipër e përgjegjësive sociale në Shqipëri*, 2013, fq. 8-9 <https://albania.savethechildren.net/sites/albania.savethechildren.net/files/library/Analyze%20Studimore%20%20Anglisht%20Meridia-%20FINAL.pdf>



# Të Dëgjosh Mendimet e Fëmijës

Mundësia që fëmija dhe familja e tij/saj të shprehin mendimet e tyre dhe të marrin pjesë të proceset ku merren vendime për ta, jo vetëm që është një e drejtë e parashikuar tek e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut<sup>29</sup>, por edhe një mënyrë për të garantuar ndërhyrje efektive që do të ndihmojnë fëmijën dhe familjen për të dalë nga situatat e rrezikshme. Ka një mungesë të përgjithshme të fëmijëve në pjesëmarraje, sidomos për ata për vulnerabël, pikërisht për vendimet që ndikojnë në jetën e tyre dhe kjo replikohet brenda sistemit dhe shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri. Megjithëse, politikat dhe udhëzuesit, si Protokollin për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe udhëzimet për Punën në Rrugë që pritet nga fundi 2015, e vendosin fëmijën në qendër të sistemit të mbrojtjes, kjo nuk ndodh në praktikë.

Vendimet që merren nga NJMF-ja ose grupet multi-disiplinare, mundet, por jo gjithmonë të diskutohen më parë me fëmijën ose familjen e tyre. Një PMF nga Tirana tha: “Marrim më shumë në konsideratë mendimin e familjes, jo të fëmijës.” Por, e pranoi se kjo ndodh më shumë për shkak të mentalitetit: “NJMF-ja se kupton sa e rëndësishme është të pyesësh fëmijën, ndërsa institucionet nuk kanë kapacitetin dhe kohën për të komunikuar me fëmijën dhe ta pyesin se çfarë do, kur vjen puna tek aktorët e tjerë si shkolla, shëndetësia, zyrat e punësimit dhe policia është edhe më keq akoma.”



# Konkluzione dhe Rekomandime

Historitë e këtyre fëmijëve të përmbledhura tek ky material mund të jenë edhe historitë e mijra fëmijëve në Shqipëri që përballen me të njëjtat rreziqe dhe kanë të njëjtat nevoja për mbrojtje. Zamira, Leonora, Ardi dhe Ervini të gjithë në një mënyrë apo një tjetër janë kontaktuar dhe asistuar nga shërbimet e mbrojtjes dhe të përkrahjes. Por, për të gjithë rastet ndërhyrja adreson vetëm nevojat imediate të cilat i trajtojnë me urgjencë, por ngelet shumë për t'u bërë kur vjen puna tek e ardhmja e sigurt për këta fëmijë, që të mund të gëzojnë të drejtat e tyre të plota. Për të gjitha rastet është evidente mospasja e një plani afatgjatë dhe të qëndrueshëm. Por, a bën më shumë sistemi sesa thjesht 'shpëton' fëmijën nga një situatë emergjente? Por cili është qëllimi i këtij 'shpëtimi' nëse sistemi ekzistues nuk siguron fëmijën që të mos rikthehet tek cikli marginalizimit dhe abuzimit?

Edhe pse këto histori janë të zakonshme, ato janë edhe të veçanta, deri tani ato janë identifikuar dhe kanë marrë disa shërbime. Në këtë kontekst, OJQ kanë ndërhyrë dhe kanë identifikuar rastet, kanë ofruar shërbime dhe e kanë mbështetur stafin që punon për mbrojtjen e fëmijëve tek këto institucione. Varësia e 'sistemit' nga OJQ-të mbetet shumë e lartë dhe Kreu i Agjencisë Shtetëore pranoi: "Nuk do të kishim funksionuar dot pa OJQ-të, nëse do të përfundonin nësër mbështetjen e tyre." Por, ka edhe shumë fëmijë të tjerë në zona më të izoluar që nuk kanë asnjë akses tek shërbimet, apo OJQ-të dhe historitë e të cilëve janë të 'padukshme' për shkak të pranimit dhe tolerimit të abuzimit dhe shfrytëzimit nga mjedisi ku jetojnë si dhe fakti që nuk kuptojnë se është përgjegjësia e të gjithëve kujdesi për të garantuar mirëqenien e fëmijës.

Mbrojtja e fëmijëve në Shqipëri ka ecur shumë për ndërtimin e strukturave dhe mekanizmave që ofrojnë mbrojtje për fëmijët në rrezik; por ka ende shumë rrugë për të bërë që të jetë 'një sistem për mbrojtjen e fëmijëve' efektiv i cili ka shtrirjen, kapacitetin dhe burimet si për të parandaluar edhe për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi, shfrytëzimi dhe dhuna.

# Rekomandime

- Qeveria dhe autoritetet shqiptare, në të gjitha nivelet, qendrore apo vendore duhet t'i japin përparësi, të mbështesin dhe krijojnë kushtet e nevojshme që të kryhet puna midis agjencive për të parandaluar, për të marrë masa dhe për të ndjekur rastet e mbrojtjes së fëmijëve.
- Qeveria shqiptare duhet të zhvillojë dhe miratojë një ligj për Mbrojtjen e Fëmijëve për të garantuar se kuadri ligjor mbulon plotësisht dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse mbrojtjen e fëmijëve dhe sqaron proceset, rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve të ndryshme si në nivel kombëtar ashtu edhe lokal.
- Duhet të zhvillohet një sistem cilësor i pavarur monitorimi për llogaridhënien për të siguruar se NJMF si dhe përfshirja e aktorëve të tjerë në nivel lokal, janë të suksesshëm për të identifikuar, referuar dhe menaxhuar raste të fëmijëve që kanë nevojë për mbrojtje. Kjo duhet të përfshijë edhe punën pas situatës emergjente dhe ndërhyrjes imediate, për të adresuar rreziqet afatgjatë.
- Autoritetet në nivel qendror dhe vendor duhet të garantojnë se ndryshimet në administratën publike dhe ofrimi i shërbimeve në nivel loka, për shkak të reformës territoriale dhe asaj të përkrahjes sociale, nuk duhet të sjellin reduktim të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve, por të përpiqen për fuqizimin e këtyre shërbimeve dhe të rritet prania e tyre në gjithë vendin.
- Autoritetet duhet të sigurohen se do të ketë buxhet të mjaftueshëm për NJMF-të në nivel lokal, përfshirë kostot operacionale, si vizitat në familje dhe për asistencë në raste emergjente për familjet në nevojë.
- Autoritetet në nivel qendror dhe lokal duhet të garantojnë se stafi i punësuar si punonjës social tek Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve apo tek shërbimet e tjera për mbrojtjen e fëmijëve, duhet të demonstrojnë njohuritë dhe aftësitë minimale; dhe se trajnimi për mbrojtjen e fëmijëve do të shtrihet tek të gjithë aktorët që marrin pjesë direkt apo indirekt për ofrimin e shërbimeve mbrojtëse dhe të tjera.
- Autoritetet duhet të garantojnë se shërbimi për fëmijët e mbijetuar nga abuzimi seksual do të jetë i specializuar për të trajtuar dhe për t'iu përgjigjur këtyre rasteve, përfshirë praninë e qendrave të emergjencës që janë lehtësisht të aksesueshme në të gjithë vendin. Krahas kësaj, duhet të bëhet trajnim dhe ndërgjegjësim për të gjithë aktorët që kontaktojnë fëmijët e mbijetuar nga abuzimi seksual.
- Autoritetet qeveritare duhet të forcojnë përpjekjet për të adresuar faktorët strukturor, si varfëria, gjinia dhe traditat që sjellin çojnë në situata si puna tek fëmijët, fëmijë në situatë rruge, martesë në moshë të hershme, braktisje e shkollës ose institucionalizim të fëmijëve, nëpërmjet asistencës sociale dhe strehimit, programeve për gjenerimin e të ardhurave dhe programeve të prindërimit duke i vënë theksin rolit gjinor dhe traditave, për të fuqizuar familjet dhe të rinjtë në situata vulnerabël.



- Autoritetet duhet të vazhdojnë përpjekjet për deinstitutionalizimin duke siguruar disponueshmërinë e skemave alternative si birësimi apo përkrahja nga të afërmit, apo shtëpi me grupe të ngjashme me familjet; fëmijët e vendosur në institucione për arsye ekonomike dhe sociale dhe familjet e tyre duhet të mbështeten që të kthehen tek familjet, duke garantuar interesin më të lartë të fëmijës dhe praninë e shërbimeve në komunitet në momentin që rikthehet fëmija.
- Autoritetet në nivel qendror dhe vendor duhet të vazhdojnë praktikën e mirë të qasjes proaktive për të identifikuar dhe asistuar fëmijët dhe familjet në situatë rruge. Megjithatë, mbështetja e vazhdueshme duhet t'i ofrohet familjes nëpërmjet programeve të fuqizimit, përfshirë aftësimin për jetën, akses për punësim dhe aftësitë prindërore.
- Qeveria shqiptare duhet të zhvillojë dhe miratojë një Kod gjithëpërfshirës për Drejtësinë për të Mitur që njeh nevojat e veçanta të fëmijëve në konflikt me ligjin, duke adresuar interesin më të lartë të fëmijës duke e vendosur atë në qendër të sistemit dhe të parashikojë procedura miqësore për fëmijën që nga hetimi e deri tek ndalimi tyre. Autoritetet ligjzbatuese duhet të garantojnë koordinim me organet për mbrojtjen e fëmijëve për të siguruar riintegrim efektiv të fëmijëve që dalin nga institucionet e burgut.

# Bibliografia e Përzgjedhur dhe Burimet

Ministria Shqiptare e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Terre des hommes Misioni në Shqipëri, UNICEF në Shqipëri, *“Protokolli Punës për Punonjësit e Mbrojtjes të Fëmijëve”*, 2010

Enkelejda Lopari et. al., *Reforma e Shërbimit të Përkrahjes Sociale në Shqipëri: Vlerësimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimit social për modelin e menaxhimit të rastit në fushën e shërbimeve sociale*, dhjetor 2013

Qendra Evropiane e të Drejtave Rome, *Dorëzimi i përbashkët i ERRC tek CEDAË-CRC Rekomandime të Përgjithshme / Komentet për praktikën e demshme: Martesa e fëmijëve tek romët*, shtator 2011

Gary Westwater dhe Vladan Jovanović, për Austrian Development Cooperation dhe UNICEF në Shqipëri, *Vlerësimi i ndërhyrjes së Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve, në kuadër të reformës së sistemit të mirëqenies sociale dhe decentralizimit të procesit të shërbimeve sociale në Shqipëri*, Gusht – Shtator 2009

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) dhe Instituti Statistikave (INSTAT) i Republikës së Shqipërisë, *Fëmijët që punojnë në Republikën e Shqipërisë: Rezultatet e sondazhit kombëtar të 2010 për fëmijët që punojnë*, korrik 2012

Irene Stevens, Graham Connelly dhe Ian Milligan, *Vlerësim për ecurinë e kujdesit alternativ të projektit pilot për kujdesin birësues në Shqipëri*, Shtator - Tetor 2013

Peter Evans me OJQ 'Future Centre', *Shqipëri, Sondazh për fëmijët banorë të institucioneve publike dhe jo-publike në Shqipëri*, korrik 2014

Rachel A Harris dhe Ian Milligan, për Terre des hommes Misioni në Shqipëri, *Vizioni i përbashkët për mbrojtjen sistematike të fëmijëve*, maj 2014 (raport i brendshëm)

Renate Winter dhe Peter Evans, për Terre des hommes Misioni në Shqipëri, *Kërkim në sistemin aktual mbi fëmijët në konflikt me ligjin*, projekt raport që pritet të publikohet në 2015



Save the Children, *Analizë mbi gjendjen e të drejtave të fëmijëve: Shqipëri*, korrik 2012

Save the Children dhe Meridia Shqipëri, *Riintegrimi i fëmijëve dhe të rinjve në konflikt me ligjin dhe marrja përsipër e përgjegjësisë sociale në Shqipëri*, 2013

Terre des hommes, *Zgjerimi i Sistemeve për Mbrojtjen e Fëmijëve: Politika tematike*, 2011

Terre des hommes Misioni në Shqipëri, *Zhvillimi i Rrjetit të Sigurisë së Mbrojtjes së Fëmijëve – Faza II – Raporti vjetor 2014* (Raporti brendshëm)

Terre des hommes Misioni në Shqipëri, *Kontributet e Progres Raportit të BE-së 2015* (jo publike)

UNDP, *Në rrezik: Vulnerabiliteti shoqëror i romëve në Shqipëri*, Gusht 2006

UNICEF dhe Save the Children, *Studim kombëtar për fëmijët në situatë rruge në Shqipëri: Nga lypja në rrugë drejt mbrojtjes dhe kujdesit*, prill 2014

## Fondacioni Terre des hommes Misioni në Shqipëri


**Adresa:** Rruga "Faik Konica", Vila 19


PO Box 7426, Tirana - Albania


**T / F** +355 (0) 42 46 88 11

**E-Mail:** [info@tdhalbania.org](mailto:info@tdhalbania.org)

**Web:** [www.tdh.ch](http://www.tdh.ch) | [www.childhub.org](http://www.childhub.org)

 Terre des hommes Albania

 Terre des hommes Albania

 @TdhAlbania